

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 34/2019, “PËR
ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA”, I
NDRYSHUAR”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar”

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- efektet e mundshme në zbatimin praktik nga institucionet përkatëse;
- çdo aspekt që mund të ndihmojë në rritjen e efektivitetit dhe zbatueshmërisë së projektaktit në praktikë.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektvendimit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 19 dhjetor 2025 deri më 16 janar 2026.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>:

- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinatorit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinatorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Projektligji u hartua nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe do të përcillet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Energjisë dhe Infratrakturës dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor.

Sfondi i propozimit legjislativ:

Projektligji parashikon bashkëveprimin dhe bashkërendimin e proceseve të sekuestrimit/konfiskimit, qoftë me organet e drejtësisë, ashtu edhe me organet e tjera administrative apo të pushtetit vendor.

Një nga problematikat kryesore që rregullon ky projektligj, e në vijim plotësimi me akte nënligjore të Këshillit të Ministrave, është përcaktimi i rregullave të administrimit të pasurive të llojit monedha virtuale, të cilat herë pas here kanë qenë një sfidë për këtë institucion, referuar problematikave të hasura.

Në aspektin procedural, ky projektligj minimizon kohën dhe afatet e shitjes së pasurive të sekuestruara/konfiskuara nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, duke sjellë përfitime në rritjen e të ardhurave, si të agjencisë, ashtu edhe të buxhetit të shtetit dhe fondeve të posacme, të cilat shërbejnë ndër të tjera, për shërbime të ndryshme sociale dhe institucionale.

Propozimet:

Në kuadër të ndryshimeve ligjore që po ndërmerren për përfshirje në objektin dhe qëllimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, jo vetëm të pasurive të sekuestruara/konfiskuara nga organet e drejtësisë, por edhe të pasurive të sekuestruara/konfiskuara me vendime të pushtetit vendor apo organeve të tjera, ndër to edhe ndërtimet pa leje, si dhe referuar numrit gjithnjë e në rritje të vendimeve të

sekuestrimit/konfiskimit të pasurive të luajtshme e të paluajtshme nga organet kompetente, apo të pasurive të llojit “Kriptomonedha” (monedha virtuale), propozohet ky projektligj, me masa dhe me synimin e garantimit të një mirëadministrimi, përmes përmirësimit të bazës ligjore aktuale.

Objektivat të cilat synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji, kanë të bëjnë me mirëadministrimin dhe përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, jo vetëm nga aktet e organeve të drejtësisë, por edhe të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga akte të organeve administrative, pushtetit vendor, siç janë edhe ndërtimet pa leje, duke mundësuar rikthimin në komunitet të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme.

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si mendoni se mund të ndikojë ky projektligj në:

a. në përmirësimin e mirëadministrimit dhe përdorimit efikas të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, përfshirë pasuritë e sekuestruara nga organet e pushtetit vendor, ndërtimet pa leje, në funksion të rritjes së të ardhurave publike dhe rikthimit të përfitimeve në komunitet?

b. në forcimin e bashkërendimit ndërinstitutional ndërmjet organeve të drejtësisë, organeve administrative dhe pushtetit vendor, si dhe në përshpejtimin e procedurave të administrimit dhe shitjes së pasurive të sekuestruara/konfiskuara, duke garantuar mbrojtjen e interesit publik dhe transparencën?